

Drejtoria e Shërbimeve dhe Transportit

Petrît Shyti

Mban pozicionin e Drejtorit të Shërbimeve dhe Transportit që nga viti 2015. Më parë ka punuar si inxhinier mekanik te Uzina Mekanike e Naftës. Ka punuar te Zyra e Punës Kuçovë dhe Uzina e Përpunimit të Naftës.

Ka kryer studimet në Universitetin e Tiranës për Inxhinieri Mekanike. Gjatë karrierës së tij ka kryer disa kualifikime nga USAID dhe Parntens Albania në fushën antikorrupsion dhe të shërbimeve publike.

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit është përgjegjëse për miradministrimin e çdo çështje që lidhet me shërbimet publike ndaj qytetareve, me qëllim arritjen e objektivave dhe përmbushjen e rezultateve të kërkuara nga kjo njësi organizative nëpërmjet përdorimit eficient dhe efikas të burimeve financiare dhe njerëzore në dispozicion të saj.

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit është përgjegjëse për zbatimin e strategjive, politikave dhe planeve të fushës përkatëse në të gjithë territorin e Bashkisë, si dhe për sektorët në varësi, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej saj, në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe të transparencës.